



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

*Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 14.06.2016, ora 12:30

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi dhe votimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, dt. 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”” të ndryshuar.

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Petrit Vasili, Vexhi Mucmataj, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Keltis Kruja.

**Të ftuar:**

Romana Vlahutin - Ambasadore e Delegacionit të BE-së në Tiranë

Donald Lu - Ambasador i SHBA-së në Tirane

Rainer Deville - Shef i misionit të EURALIUS-it në Shqipëri

Jon Smibert - përfaqësues i misionit të OPDAT-it në Shqipëri

Sokol Sadushi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Gent Ibrahimimi - Ekspert i Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

Aurela Anastasi – Eksperte e Nivelit të Lartë pranë Komisionit të Posaçëm

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Përshëndetje të gjithëve!

Siç është bërë e njohur dhe siç jeni njoftuar, sot, në këtë mbledhje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi, do të shqyrtojmë dhe votojmë nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”

Komisioni në mbledhjet e tij të mëparshme ka shqyrtuar projektligjin në parim, ka votuar projektligjin në parim, në mënyrë unanime, dhe i ka hapur rrugë procedurës normale parlamentare për shqyrtimin dhe votimin nen për nen dhe në tërësi të projektit.

Projekti që po shqyrtojmë, që do të votojmë sot nen për nen dhe në tërësi është një projekt i rëndësishëm, sepse është stacioni më i rëndësishëm i punës së këtij komisioni, pasi do të përmbyllë një nga përgjegjësitë për të cilën është mandatuar nga Kuvendi i Shqipërisë ky komision, votimin e projektit kushtetues. Natyrisht, ky është një stacion tejet i rëndësishëm, përcaktues, por nuk është stacioni i fundit, as për vetë projektin, as për vetë procesin.

Nuk është stacioni i fundit për projektin, sepse projekti, pas kësaj mbledhjeje të komisionit, do të ndjekë rrugën që parashikon Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit, për të shkuar në seancë plenare sipas parashikimeve përkatëse, procedurale, kushtetuese dhe në zbatim të Rregullores së Kuvendit.

Por, natyrisht, nuk është stacioni i fundit për punën e këtij komisioni, për shkak se menjëherë pas saj, ashtu siç kemi deklaruar dhe siç jemi dakordësuar, ne do të vazhdojmë shqyrtimin e ligjeve të tjera me prioritet 7 ligjet bazë, 7 ligjet kuadër, që jetësojnë dhe bëjnë të zbatueshëm këtë projekt kushtetues.

Edhe projekti në vetvete ka një çështje të mbetur pezull, i cili është debati që ka të bëjë me formatimin e institucioneve, për të cilin ka sot një debat të ndezur politik, por ka edhe një dialog dhe një komunikim politik, ka edhe negociata, për të qenë transparentë dhe për t’iu përgjigjur realitetit të zhvillimeve, të cilat synojnë që të gjejnë një zgjidhje që e bën jo 99%, por 100% të dakordësuar konsensualisht këtë projekt.

Unë besoj dhe shpresoj që me vullnet të mirë mund të gjendet kjo zgjidhje. Natyrisht, jemi të detyruar sot, edhe në kushtet që nuk kemi arritur pikërisht në këtë zgjidhje finalizuese të këtij elementi të veçantë të këtij komponenti të veçantë, ta votojmë, sepse kjo nuk na pengon që negociatat që po bëjmë, që do t’i quaja në rrugë të mbarë, ende jo të

suksesshme, por në rrugë të mbarë, produkti që do të nxjerrim ta reflektojmë për këtë pjesë, në hapat e mëtejshëm proceduralë që do të ndjekë projekti kushtetues.

Është e rëndësishme ta bëjmë këtë gjë edhe për ta lënë më të qetë këtë ngërç politik për ta zgjidhur më me qetësi, por edhe, sepse jemi të imponuar nga afatet kohore, të cilat na kërkojnë vazhdimin e procedurës në mënyrë që të respektojmë edhe sesionin parlamentar.

Gjithsesi, do të diskutojmë më tej për këtë çështje, siç është i njohur fakti që ky projekt që kemi, nuk është një projekt tërësisht i punuar vetëm nga ekspertët shqiptarë, dhe nuk ka vetëm kontributin tonë këtu, në këtë tavolinë, ka edhe kontributin e dy partnerëve të rëndësishëm strategjikë për shqiptarët dhe për Shqipërinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian. Nuk bëjmë asnjë gabim nëse i rifaletojmë ata, Shtetet e Bashkuara, Bashkimin Europian, përfaqësuesit e tyre këtu, ekspertët e tyre për kontributin e jashtëzakonshëm që kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në këtë proces fundamental për zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës në Shqipëri. Është kjo arsyeja, që sot, me kërkesën e tyre, kemi mirëpritur në këtë tryezë pikërisht dy partnerët bashkëkryesorë, përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian, ambasadorin e nderuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë, zotin Donald Lu, dhe ambasadorin e nderuar të Bashkimit Europian në Shqipëri, zonjën Romana Vlahutin.

Kam kërkuar që në nisje të këtij procesi, në cilësinë e bashkautorëve të gjithë kësaj reforme dhe këtij produkti t'i drejtohen me një fjalë të shkurtër reciprokisht këtij komisioni.

Fillimisht besoj se kam edhe miratimin dhe pëlqimin tuaj që t'ia kaloj fjalën ambasadores së Bashkimit Europian, zonjës Romana Vlahutin.

**Romana Vlahutin** - Ju falenderoj se tepërmi që na dhatë mundësinë që të jemi në këtë mbledhje bashkë me ju. Në emër të institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të 28 shteteve anëtare të BE-së, dëshiroj t'iu falenderoj të gjithë për partneritetin, bashkëpunimin dhe punën shumë të madhe që është bërë për të arritur atë që keni në duar sot, një paketë me ndryshime kushtetuese për reformën në drejtësi.

Kjo reformë është reforma më e rëndësishme që do të ndërmarrë Shqipëria në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim. Gjithashtu, reforma merret edhe me kapitujt 23 dhe 24 dhe, për rrjedhojë, është plotësisht në përputhje me standardet e BE-së.

Të gjithë janë plotësisht të ndërgjegjshëm se kredibiliteti i kësaj reforme do të duhet të ruhet në çdo hap, dhe udhëzimet e qarta që kemi nga zyrat tona qendrore janë se veting-u nuk duhet kompromentuar nga influencat jo të duhura të partive politike. Ne sinjorisht shpresojmë për një miratim të shpejtë të reformës me shumicë kushtetuese para mbylljes së sesionit

parlamentar të verës në mënyrë që procesi i integrimit të Shqipërisë në BE të mos ndërpritet. Nëse ka ende ndonjë çështje që duhet zgjidhur, le të punojmë për të gjetur zgjidhje, por procesi duhet të vazhdojë të ecë përpara.

BE po planifikon të japë asistencë thelbësore përmes misionit monitorues ndërkombëtar dhe ne shpresojmë plotësisht që përpjekjet tona të përbashkëta do t'u japin qytetarëve të Shqipërisë sistemin e drejtësisë që ata kërkojnë dhe meritojnë.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit, zonja Ambasadore, për mesazhin që përcollët në emër të Bashkimit Europian, në shprehje të konsideratës dhe vlerësimeve inkurajuese për procesin!

Fjalën po ia kaloj tani ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotit Donald Lu.

**Donald Lu** – Zoti Xhafaj dhe zoti Bylykbashi,

Anëtarë të komisionit,

Gjatë vitit të shkuar, Romana dhe unë kemi folur shumë për reformën në drejtësi dhe unë kam vetëm dy gjëra më shumë për të thënë.

Së pari, dua të falënderoj anëtarët e këtij komisioni për përkushtimin dhe për sakrificën në mbështetjen e reformës në drejtësi!

Së dyti, drafti që do të diskutoni dhe do të votoni sot ka mbështetjen e plotë dhe të qartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Ambasador, për mbështetjen e vazhdueshme që i keni dhënë këtij procesi dhe për vlerësimet që adresuat ndaj anëtarëve dhe këtij komisioni, si dhe për mbështetjen që i jepni këtij projekti me rëndësi historike për fatet e mëtejshme të integrimit dhe të zhvillimit të demokracisë dhe shtetit të së drejtës në vend!

Besoj se tani është momenti që t'u japim mundësinë ekspertëve të bëjnë një paraqitje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Para ekspertëve do ta kërkonin ju fjalën?

Fjalën e ka kërkuar zoti Bylykbashi.

**Oerd Bylykbashi** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar ambasadorë, zonja Vlahutin dhe zoti Lu,

Të nderuar përfaqësues të OPDAT-it, të EURALIUS-it dhe ekspertë këtu në këtë komision, sot jemi përpara një mbledhjeje, e cila në vetvete është moment kritik.

Siç e kemi bërë të qartë, madje siç është bërë e qartë në draftin e paraqitur më 4 maj nga vetë OPDAT-i dhe EURALIUS, në krye të draftit thuhet qartë: “Ky draft nuk reflekton çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike”, pra zgjidhje politike, por edhe më qartë se kjo,

është thënë nga Komisioni i Venecias që çështje të caktuara kërkojnë vendimmarrje politike. Pra, nuk ishin opinion i ekspertizës.

Sot e kësaj dite nuk kemi të gjitha zgjidhjet politike për çështjet themelore, principiale me të cilat ecet përpara në këtë proces.

Siç mund ta dini dhe siç duhet ta dini, në këtë moment ka në vazhdim një proces negociimi politik për të gjetur zgjidhje vetëm për çështjen e fundit të rëndësishme që ka mbetur pas propozimit për kompromis të bërë në datën 31 maj, për thjeshtim të sistemit dhe për të zgjidhur, gjithashtu, më pas edhe çështjen e vendimmarrjes për emërimin në të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë, në mënyrë të veçantë tek institucionet kolegjiale. Pra, ka mbetur vetëm një çështje për t'u zgjidhur.

Është bërë shumë i qartë pozicioni i Partisë Demokratike, i opozitës në tërësi, në lidhje me zgjidhjen e kësaj çështjeje. Zgjidhja është vetëm një dhe gjendet ekzakt te paragrafi 88 i opinionit final të Komisionit të Venecias. Zgjidhja nuk mund të jetë as më shumë, as më pak sesa ajo, e cila, në mënyrë fare të qartë, kërkon që në të katër organizmat kolegjialë të garantohet, në mënyrë proporcionale, përfaqësimi i opozitës për të garantuar, siç u bë e qartë në të gjitha ato që u thanë më pas, që kjo reformë është e pakapshme nga asnjëra palë politike, ku palët janë ekuidistante nga rezultati i reformës në drejtësi. E përsëris: zgjidhja që opozita ka propozuar, me të cilën mbyllet menjëherë kjo reformë e rëndësishme kushtetuese, është vetëm një dhe shumë e thjeshtë. Ajo gjendet në paragrafin 88 të Komisionit të Venecias, e pranuar nga maxhoranca, ky draft bëhet gati në votim në parim në mënyrë që të përmbysim të gjithë paketën. Çdo zgjedhje tjetër nuk i shërben kësaj zgjidhjeje.

Pra, ajo që ne kërkojmë dhe ju ofrojmë në këtë moment, është të bëjmë një zgjidhje të thjeshtë, funksionale, të propozuar nga Komisioni i Venecias, në të cilën ka pasur konsistencë nga të gjitha palët, nga dita e parë e deri më sot, pra i vetmi arbitër në këtë çështje është Komisioni i Venecias. Të gjithë kemi pranuar që zgjidhja do të jetë vetëm sipas Komisionit të Venecias. Çdo gjë tjetër bie nën kriter dhe nëse nuk bie mbi këtë kriter, do të mbetemi te ajo që thotë Komisioni i Venecias.

Në këtë moment, çfarëdo lloj gjëje që është ngritur para këtij komisioni, nuk reflekton atë që kërkon Komisioni i Venecias, zgjidhje politike për një çështje që nuk është teknike. Nuk reflekton atë që vetë ekspertët ndërkombëtarë më 14 maj thoshin se ne nuk i kishim zgjidhur këto çështje. Pra, në këtë situatë kaq të rëndësishme, kur negociatat delikate kërkojnë dhe janë afër një zgjidhjeje, çdo gjë tjetër unilaterale, qoftë edhe nisja e procesit në mënyrë unilaterale, si kjo sot, nuk i shërben zgjidhjes, kompromisit dhe për rrjedhojë, nuk i shërben asaj që ne kërkojmë, që së shpejti të miratojmë reformën në drejtësi.

Kisha edhe diçka tjetër. Kjo maxhorancë nuk i ka 94 votat në asnjë formë, që garanton një integritet të procesit përtej çdo dyshimi, një legjitimitet të produktit në sytë e shqiptarëve. Nuk garanton përveçse me 2 forma: e para, trafikimi i votave në parlament dhe e dyta, qëllimi për ta dështuar përkundër 94 votave të pabëshme dhe si rrjedhojë, për ta shtyrë me një vit reformën në drejtësi. Besoj se të dyja kanë një kosto të jashtëzakonshme politike, por edhe më shumë se politike.

Opozita nuk është e gatshme për asnjë sekondë t'i rrezikojë të dyja, por është e gatshme që, siç jemi duke negociuar, të gjejnë një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje të vetme, e cila do të garantojë që të katërta organet kolegjiale (siç thotë Komisioni i Venecias dhe askush nuk mund ta zhvendosë këtë që thotë ai, sepse është opinion final), të garantojnë përfaqësimin e opozitës, të garantojnë pavarësinë e sistemit nëpërmjet ekuidistancës politike. Çdo gjë tjetër nuk i shërben kompromisit.

Zgjidhja është shumë e thjeshtë. Është vetëm një çështje, të nderuar kolegë, të mos e çoni kompromisin në rrugën që e dëmton. Topi është në fushën tuaj. Ne kemi bërë propozimet konkrete edhe mbi bazën e germës që propozon Komisioni i Venecias. Jepini kohën e nevojshme, sepse në të kundërt, është siç po e bëni edhe sot: një proces unilateral, pa zgjidhjet politike të kërkuara edhe nga Komisioni i Venecias dhe për rrjedhojë vetëm në dëm të reformës në drejtësi, që ne si opozitë, e duam sa më shpejt. Çështjen nëse e doni edhe ju, do ta tregoni nëpërmjet kompromisit në këtë negociatë që është e fundit, por shumë e rëndësishme.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Ju duhet të na dëgjoni edhe ne!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Urdhëroni, zoti Majko për procedurë!

**Pandeli Majko** – Të them të drejtën, kjo është një histori kaq absurde dhe absurditeti fillon nga salla ku ne kemi bërë këtë diskutim për pavarësinë e drejtësisë. Kjo dikur ka qenë salla e byrosë politike, ku merreshin vendime për gjithçka dhe për çdo gjë. Bile këtu merreshin vendime, para se të merreshin vendimet e gjykatës dhe duket sikur tema është po ajo dhe ne po diskutojmë pavarësinë e drejtësisë, e cila në thelb ka ndarë regjimin nga demokracia. Mua nuk më mbetet gjë tjetër, jashtë çdo logjike të protokollit, të falënderoj së pari, ekspertët ndërkombëtarë dhe vendas për punën shumë të mirë që kanë bërë dhe t'u bashkohem deklarimeve të dy miqve të Shqipërisë dhe shqiptarëve: ambasadorit të SHBA-ve dhe ambasadores së BE-së, në faktin që ky draft është ai që do të hapë dyert e negociatave mes Shqipërisë dhe BE-së.

Për sa i përket faktit që ka vetëm një kusht apo vetëm një gjë të vogël për të cilën pritet ok-i ynë, si maxhorancë, ashtu siç u tha nga parafolësi i opozitës, që e la sillën në mënyrë të çuditshme, unë dëshitoj t'ju them se kam lexuar letrat e Komisionit të Venecias, vërejtjeve që ka bërë, edhe për të gjitha logjikat që ai ka shtruar lidhur me çështjet e reformës së drejtësisë. Ajo që dëshiroj të nënvizoj, unë nuk e di se cili ka qenë përkthyesi, pa dashur të bëj ironi dhe humor, i opinionit të Komisionit të Venecias lidhur me këtë çështje që pretendon Partia Demokratike. Më lejoni të citoj se Komisioni i Venecias është shprehur në mënyrë të qartë: “Procesi i nominimit është po aq i rëndësishëm sa edhe metoda e zgjedhjes së anëtarëve”. Kam parasysh dy institucionet më të rëndësishme, të cilat Partia Demokratike apo opozita kërkon që të ketë njerëz të nominuar nga partitë politike, pra, në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, që në partitë të ndajmë se kush do të jetë, se kush do të bëjë çfarë në këto dy institucione kaq të rëndësishme, të stigmatizuara apo që do të aprovohen me këtë reformë të drejtësisë. Po vazhdoj citimin atje ku e lashë të Komisionit të Venecias: “Distanca e tyre nga politika mund të sigurohet nëpërmjet një procesi të hapur dhe transparent nominimi me nismën e organeve të pavarura nominuese dhe të përfundohet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Ky proces nominimi duhet të bëjë të mundur që parlamenti të detyrohet të bëjë një përzgjedhje mes kandidatëve më të kualifikuar (po e citoj) dhe jo të emëruar dhe politikë”. Nëse unë përpiqem ta kuptoj këtë që shpreh opinionin e Komisionit të Venecias është e zeza mbi të bardhë, i fton partitë politike të qëndrojnë larg procesit të nominimit. Vendet e rezervuara për partitë nuk janë as më shumë dhe as më pak, emërime politike. Pikërisht për këtë arsye në ndahemi dhe ajo që quhet pika e fundit nga përfaqësuesit e opozitës nuk është e fundit pikë. Është një problem shumë i madh, është një parim shumë i rëndësishëm, i cili në fakt na kthen tek koncepti në të cilin funksionon sot sistemi i drejtësisë nën kontrollin e plotë të politikës. Maxhoranca pranoi votimin me dy të tretat dhe ne menduam se kjo do të ishte një zgjidhje që e përfshinte në mënyrë substanciale opozitën në parlament. Ajo që më shqetëson është fakti se këtu diskutohet sikur ne po bëjmë disa rregulla, të cilat do të kenë 6 muaj, një vit, dy vjet jetë dhe nuk po diskutojmë ndryshime kushtetuese, të cilat do t'i rezistojnë dhe duhet t'i rezistojnë: 10, 20, 30 apo 40 vjetëve. Mendoj se është normale që ne sot, që jemi në pushtet do të na vijë dita që do të dalim në opozitë, dhe është normale që kolegët, të cilët janë në opozitë do t'u vijë dita të vijnë në pushtet. Kjo mënyrë e të diskutuarit, sikur ne do të jemi tërë kohën në pushtet dhe këta tërë kohën në opozitë është krejtësisht e padobishme dhe ka sjellë diskutimin në një lloj udhëkryqi, i cili po citoj kolegun që tha: “Duhet një zgjidhje politike”. Dakord, ne jemi të gatshëm dhe besoj se shpreh edhe opinionin e kolegëve për

çdo lloj zgjidhjeje politike, por zgjidhjet politike duhet të kenë një koncept të qartë juridik, se nuk po diskutojmë një program të një qeverie koalicioni me Partinë Demokratike, por ne po diskutojmë dokumentin më të rëndësishëm, më fundamental, mbi të cilin lidhet besimi i publikut te institucionet e shtetit shqiptar. Mendoj se mënyra e diskutimit, largimi unilateral i përfaqësuesve të opozitës në një kohë që na ftuan të mos marrim vendime unilaterale, e bëjnë këtë histori deri diku edhe më absurde, i shtohen kontekstit të absurditetit të kësaj salle që ka parë shumë, sidomos në marrëdhënien me drejtësinë.

Unë mendoj, zoti kryetar, që t'i bashkohem asaj që thatë edhe ju në fillim dhe ta ripërsëris faktin se jemi përballë një detyre shumë të rëndësishme, delikate sigurisht, propozoj të procedojmë duke votuar nen për nen draftin. Më besoni këtë do ta thosha edhe po të ishin prezent kolegët e opozitës, që ne ta mbajmë dokumentin si një dokument të hapur për të diskutuar në vazhdim të gjitha çështjet që ata mendojnë se mund t'i negociojnë me ne, çdo zgjidhje politike, e cila ka një kuptim juridik dhe i përgjigjet filozofisë së kësaj reforme, një reformë, e cila nuk është as e Partisë Socialiste, as e Lëvizjet Socialiste për Integrim, as e maxhorancës, por është një reformë e cila do të hapë dyert e Shqipërisë në negociatat në familjen e madhe europiane.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Ka ndonjë gjë tjetër nga kolegët?

Do të bëj një sqarim, nëse është e nevojshme dhe në cilësinë e kryetarit të këtij komisioni, duke mos i ikur për asnjë moment, për asnjë sekondë këtyre 18 muajve përgjegjësisë sime politike dhe institucionale, se ky as ka qenë dhe as do të jetë një proces i njëanshëm në kuptimin parlamentar të tij, ne jemi sot këtu si pjesë e një rrugëtimi procedural parlamentar, një proces parlamentar i urdhëruar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.96 të nëntorit të vitit 2014. Është Kuvendi i Shqipërisë ai që ka pasur vullnetin politik parlamentar institucional, për t'i hapur rrugë këtij procesi. Na ka dominuar ne për ta zhvilluar këtë proces, ndaj ne kemi detyrimin për ta ndjekur dhe për ta respektuar këtë detyrim të urdhëruar nga ligjvënësi.

E thashë në fillim dhe po e theksoj përsëri: vetë ky projekt nuk është stacioni i fundit. Përkundrazi, ka një rrugë tjetër, ka disa stacione të tjera për të kaluar, deri në momentin kur do të marrë miratimin final. Ne përmbyllim këtu punën tonë si komision, por ka disa procedura të tjera parlamentare për ta bërë këtë një dokument final, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.



Natyrshëm lind pyetja: po pse sot votimi? Mendoj se ka tri arsye të mëdha, të cilat nuk janë thjesht e vetëm procedurale, por janë edhe politike, janë në interes të vendit, janë në interes të procesit të integritetit të vendit, janë në interes të shqiptarëve. Arsyeja e parë e madhe është pikërisht përmbushja e afatit për shkak të nevojës për ta votuar në Kuvendin e Shqipërisë brenda këtij sesioni parlamentar, që lidhet me nevojën për ta përmbyllur këtë sesion me këtë votim, por dhe me hapat e Shqipërisë në procesin e integritetit evropian të vendit. Pra është një lëvizje e kushtëzuar nga interesa madhore të vendit.

Arsyeja e dytë është afati procedural kushtetues dhe sipas rregullores së Kuvendit, për shkak se, nga produkti që nxjerr ky komision e deri në votimin parlamentar ka edhe disa ditë e javë të tëra, janë edhe disa procedura që duhen respektuar. Arsyeja e tretë e madhe e rëndësishme është se ne, së bashku, maxhorancë e opozitë, shqiptarë dhe ndërkombëtarë, jemi angazhuar që projektit t'i bashkëngjitet edhe një paketë ligjesh prioritare, të cilat e konkretizojnë, e jetësojnë dhe e bëjnë të zbatueshëm këtë projekt kushtetues. Pra, do të thotë se nga nesër e tutje jemi të detyruar që, nëse duam që këtë paketë ta lidhim me këtë projekt kushtetues, ta miratojmë në të njëjtën kohë, të fillojmë shqyrtimin e këtyre projektligjeve.

Opozita ka qenë dhe është pjesë e kësaj vendimmarrjeje. Unë e mirëkuptoj të drejtën e saj që të kërkojë rolin, pozicionin e saj në gjithë këtë proces, pavarësisht se ndajmë pikëpamje të ndryshme.

Për hir të së vërtetës, e thashë që në fillim, dhe kolegët e opozitës e dinë: ne vërtetë nuk e kemi bërë publike, sepse është normale në një proces negociatash, por ne edhe mbrëmë në darkë kemi negociuar me opozitën, dhe jemi shumë shumë afër për të gjetur një zgjidhje, e cila është brenda kuadrit kushtetues, brenda frymës së projektit, brenda qëllimit që ka projekti dhe brenda pritshmërisë që kanë qytetarët shqiptarë për sistemin e ri të drejtësisë, si dhe brenda asaj që parashikon Komisioni i Venecias, përfshi edhe pikën 88. Natyrisht, ka një gjë ku ndahemi prerazi, deri në këto momente, e që ka të bëjë me mënyrën se si e shikojmë rolin e partive politike në procesin e vetingut. Po, është e vërtetë. Është e vërtetë, por jam i bindur se, nëse diskutojmë dhe mirëkuptohemi me qetësi, në këto ditë të mbetura do ta gjejmë një zgjidhje edhe për këtë, pa cenuar projektin, pa cenuar atë që pritet nga ai proces jetik për sistemin e drejtësisë, bazamentin mbi të cilin do të ngrihet sistemi.

Në fund fare, me shumë të drejtë, kryetari i Kuvendit, e edhe ne më pas, kemi artikulluar një gjë qartazi: kur ka lexime të ndryshme për çështje të caktuara të Komisionit të Venecias, do t'u referohemi partnerëve ndërkombëtarë dhe dy misionëve të rëndësishme. Mendoj se ka qenë një mesazh publik i drejtë ai i kryetarit të Kuvendit, e kemi thënë edhe ne

këtu, në komision, për shkak të eksperiencës që kanë, të rolit që luajnë, por edhe të kontributit që kanë dhënë në këtë proces.

Pra, kur kemi lexime të ndryshme, mund t'u referohemi partnerëve ndërkombëtarë dhe, po të jetë e nevojshme, përsëri edhe Komisionit të Venecias, sepse jemi në kohë për ta bërë edhe këtë gjë; për të thënë: a e lexojmë drejt? Këndvështrimet që kemi, a janë larg apo mund të përafrohen? Njëri apo tjetri është në përputhje me atë që kanë dashur të thotë Komisioni i Venecias?

Dikush mund të thotë me të drejtë: po ju pse s'e keni bërë këtë gjë? Sepse ne nuk donim të shkonim deri te kjo, pa provuar ta bëjmë vetë ushtrimin. Ne jemi duke provuar ta bëjmë vetë këtë dialog politik, këtë negociatë politike, këtë ushtrim, sepse kemi përgjegjësinë për ta bërë këtë ushtrim. Nëse ne nuk do t'ia dalim me sukses, apo do t'ia dalim pjesërisht me sukses. Pa dyshim që do ta zbatojmë edhe këtë këshillë të drejtë, të arsyeshme, për t'i shkuar deri në fund. Në finale ka edhe një gjë tjetër, në fund fare ky do të shkojë në parlament. Nëse nuk ka edhe votat e opozitës, nuk miratohet. Kjo do të thotë se ne jemi të detyruar të gjejmë një zgjidhje, qoftë dhe me një amendament para votimit në parlament. Kjo është fare e thjeshtë. Kjo është fare normale. Nuk ka pse vihet nën një presion të tillë.

Dhe, që të jemi fare fare korrektë, kjo s'është hera e parë që ne e bëjmë këtë ushtrim. Po ju kujtoj vetëm ndryshimet që bëmë për dekriminalizimin, që ishim në konsensus të plotë politik dhe kishin diferenca të mëdha dhe jo për 24 orë, jo për 2 javë, siç e kërkon Kushtetuta dhe Rregullorja e Parlamentit, jo 2 ditë, siç e kërkon rregullorja e zakonshme për ligjet më të thjeshta të parlamentit, por 2 orë para votimit ne e kemi ndryshuar amendamentin kushtetues në sallë. Për mua kjo është e papranueshme, por ka ndodhur. Pra, që do të thotë që ka gjithmonë një hapësirë për të shkuar, jo më kur ke ndarje dhe e ke të nevojshme, por edhe atëherë kur nuk e ke të nevojshme, në interes të një ligjëbërjeje sa më të mirë.

Prandaj ky pozicion është i pakuptimtë, kjo gjuhë është e pakuptimtë, kjo sjellje imponuese është e pakuptimtë, sepse nuk i shërben vazhdimit të dialogut të shëndetshëm. Gjithsesi, siç e thashë, jemi të imponuar për ato 3 arsye të mëdha që ne ta hedhim këtë hap sot, duke lënë të hapur të gjithë mundësinë për të reflektuar në këtë projekt, sipas dakordësisë që do të arrihet. Unë jam i bindur dhe shpresëplotë që ne do të bëjmë çdo përpjekje, po të jetë e nevojshme edhe me asistencën ndërkombëtare, që ta gjejmë këtë zgjidhje. Besoj se jeni dakord të fillojmë votimin, në qoftë se nuk ka ndonjë gjë tjetër që ka të bëjë me procedurën. Siç është e njohur nga pikëpamja procedurale, është mbyllur votimi në parim. Votimi në parim ka qenë unanim. Tani ne jemi në votimin nen për nen. Për këtë është bërë një debat shumë i gjerë lidhur me përmbajtjen e neneve.

Para se të fillojmë shqyrtimin nen për nen unë do t'ju lutem zotërinjve, dy ekspertëve të nderuar, që kanë drejtuar grupin e punës të ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, në këtë fazë të procesit, zotit Smibert dhe zotit Deville, të bëjnë një paraqitje të shkurtër.

Po, zoti Smibert e ka fjalën për të bërë një paraqitje të shkurtër të ndryshimeve që i janë bërë draftit të datës 4 maj ku është votuar në parim në këtë komision.

**Jon Smibert** - Doja të falenderoja ekspertët për punën e bërë në javët e fundit për këtë dokument final. Ky dokument ka nisur me votimin në parim të projektit të draft amendamenteve kushtetuese në 4 maj. Më pas u ra dakort për disa ndryshime, të cilat i reflektuam. Gjithashtu ristrukturoam dokumentin me ndryshimet gjuhësore për të pasur një kuptim kushtetues shqip më të saktë. Më pas ne pasqyruam sugjerimet që erdhën nga Komisioni i Venecias dhe kërkesa të tjera në lidhje me gjuhën kushtetuese. Dokumenti që paraqesim sot për ju ka nevojë për disa ndryshime të vogla teknike që mund të bëhen. Ky dokument ka pasur mbështetje të madhe nga OPDAT dhe EURALIUS. Ne jemi këtu për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja në lidhje me këtë draft.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Është e qartë, kjo besoj dhe për efekt të rekordeve të procesverbalit. Më duhet të them se ne e kemi votuar projektin në parim në datën 4 maj. Meqenëse ka pasur disa ndryshime nga ai projekt, kjo ishte dhe arsyeja pse ia dhashë fjalën zotit Smibert për të thënë se cilat ishin ndryshimet, ose më saktë fryma e ndryshimeve. Më duhet të sqaroj se projekti që kemi sot në thelb është projekti që kemi votuar në parim, por ai reflekton 3 momente të rëndësishme:

Së pari, debatin e zhvilluar në këtë komision për gjërat të cilat kemi qenë dakord të gjithë. Pra, si deputetët e maxhorancës, si deputetët e opozitës kanë shprehur të njëjtin opinion.

Së dyti, bën një riformatim duke reflektuar një kërkesë të bërë nga të gjithë kolegët deputetë. Një kërkesë që tani ishte momenti për ta reflektuar. Pra, gjuhën kushtetuese, pajtueshmërinë, terminologjinë e terminologjisë së draftit me projektin kushtetues aktual. Unë konstatoj se kjo, me sa më thanë dhe kolegët, që kanë të njëjtin mendim, është reflektuar tërësisht në këtë aspekt. Dhe sot nga ky këndvështrim kemi një dokument cilësor, tërësisht të shqipëruar mirë, por edhe të pajtueshëm me terminologjinë dhe me frymën e Kushtetutës aktuale.

Elementi i tretë është që drafti, që po shqyrtojmë sot, reflekton dokumentin konsensual të paraqitur nga përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Europian

për një zgjidhje konsensusi ndërmjet maxhorancës dhe opozitës në rishikimin e këtij drafti, duke reflektuar një pjesë të shqetësimeve të rëndësishme që kishte paraqitur opozita. Të gjitha këto elemente, të pranuar tashmë edhe nga liderшипet politike, janë reflektuar në këtë draft të cilat e kanë lehtësuar nga njëra anë strukturën e institucioneve të reja për disa elemente, pavarësisht se kemi qenë të ndarë për pozicione të ndryshme, por, në funksion të nevojës për një zgjidhje konsensuale, është gjithëpranuar të bëhen këto ndryshime, si edhe një sërë ndryshimesh të tjera të nevojshme. Kjo është arsyeja që këto tri ndryshime të mëdha, të cilat i janë bërë draftit, e kanë bërë atë, siç është deklaruar botërisht, publikisht nga liderшипet politike të të gjitha forcave kryesore në vend, një draft të gjithëpranuar, përjashtojt thjesht problemin që ka të bëjë me formatimin. Është i gjithëpranuar konsensualisht dhe publikisht se do të votohet dhe do të mbështetet nga të gjithë, sepse ka pasur këto reflektime të rëndësishme. Kështu që këto ndryshimet janë bërë. Gjithsesi, mund të vazhdojmë nën për nen.

Neni 1. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 2. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 3. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 4. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 5. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 6. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 7. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 8. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 9. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 10. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 11. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 12. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 13. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 14. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 15. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 16. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 17. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 18. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 19. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 20. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 21. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 22. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 23. A jeni dakord? Dakord. Kundër nuk ka; abstenime nuk ka.

Neni 24. A jeni dakord?

Është ajo për të cilën tha zoti Smibert?

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, grupi i ekspertëve ka hequr nga drafti termin “funksionar i lartë” dhe kanë lënë vetëm termin “ish-funksionar”. Duhet që neni 24 të jetë në harmoni me nenin tjetër, që do të diskutojmë pak më poshtë. Konkretisht, me nenin 42, që ndryshon nenin 148, paragrafi i katërt. Pra, do të përdorim termin “funksionar” apo “funksionar të lartë”? Unë jam për të përdorur termin “funksionarët e parashikuar në nenin 135”, pra të jemi pak të vëmendshëm kur t’i diskutojmë këto dy terma, pasi në shpjegimin që ka dhënë grupi i ekspertëve nuk përmendet termi “funksionar i lartë”, por renditen të gjithë funksionarët në footnote-in 22, ndërkohë që në nenin 42, që ndryshon nenin 148, është përmendur termi “funksionarë të lartë”.

**Fatmir Xhafaj** – Ju lutem, zoti Sadushi, zoti Ibrahim, zoti Deville, cili prej jush do të na bëjë një sqarim?

**Jon Smibert** – Gjuha e përdorur në nenin 135 është marrë nga gjuha që përdori z.Majko dhe neni 148 që tani krijon SPAK-un, bën referim për funksionarët e lartë. Gjuha është e ndryshme në nenin 135, pasi liston funksionarët. Ne kemi diskutuar se mbase në nenin 148 mund të bëjmë një ndryshim të vogël që referon në atë paragraf.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

Faleminderit!

Vazhdojmë.

Po, zoti Vasili.

**Petrit Vasili** – Zoti Xhafaj, ne kemi pasur një debat të hapur për këtë çështje, pra për datat, për vitet e ku di unë se çfarë.

Ne diskutuam këtu, pra juristët na dhanë argumente, duke na thënë se kohët se kur parashkruhen veprat janë të përcaktuara në ligje. Konceptin që vëmë në Kushtetutë se viti 1991 ndan epokat, unë e ngrita si shqetësim dhe e diskutuam këtë herën e kaluar. Meqenëse e kam ngritur thashë se mos ndoshta kishte ndonjë reflektim. Shoh që nuk ka dhe nuk kam për t’u dëshpëruar; do ta votoj përsëri, por një shpjegim duhet të na e jepni, sepse kolegët juristë e thonë qartë se legjislacioni ynë, ky që kemi, por edhe ky që do të perfeksionohet në bazë të ndryshimeve kushtetuese, e shpjegon qartë se kur janë dhe si veprohet për veprat; kur parashkruhen dhe nuk kanë ndonjë kufizim. Atëherë pse duhet të vendosim vite? E kemi bërë

këtë debat. Kështu, në këtë mënyrë, ne fusim politikë në Kushtetutë, që '91-shi ishte pluralizmi, më parë ishte monizmi e të tjera. Veprat janë vepra, siç e kanë kohën, kur parashkruhen. Këta shprehin juridiksionin: ish-funksionari i lartë gjykohet nga këta. Data, dita besoj se duhet t'i ikin këtij lloj përcaktimi. Ju e keni me sevda, le ta mbajmë. Hajde ta votojmë, por unë nuk jam i bindur.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord.

A keni ndonjë koment për këtë gjë, që të mund ta reflektojmë?

**Jon Smibert** – Teknikisht nuk do të përbënte ndryshim nëse është apo jo.

**Rainer Deville** – Parashkrimi nuk vlen për këtë strukturë të specializuar dhe ky do të jetë një ushtrim historik. Na duhet kompetenca për këtë strukturë për çështjet e tanishme, në mënyrë që mos të bëjë përjashtime dhe afatet e parashkrimit jo të këtij neni.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Do të thotë se mund të bëni një reflektim këtu.

**Gent Ibrahimi** – Me sa na rezulton, ajo është më shumë një mbetje nga diskutimi i versionit të mëhershëm të kësaj dispozite, e cila fliste për një afat shumë të afërt dhe ndoshta është edhe një lloj inercie. Për çka na takon ne, nuk ka ndonjë problem në rast se ajo datë hiqet. Teknikisht, nuk ka asnjë problem nëse ajo datë të hiqet.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, mund ta rishikoni.

Atëherë, e miratojmë me ndryshim. Duhet riformatuar.

Atëherë, dakord me ndryshimin? Dakord. Kundër nuk ka. Abstenime nuk ka.

Miratohet.

Neni 25.

Dakord. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 26.

Dakord. Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

*(Në të njëjtën mënyrë vazhdohet deri te neni 32)*

Neni 33.

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Zoti kryetar, ne kemi bërë një ndryshim në kompetencat e ...

**Fatmir Xhafaj** – Më fal, në cilin nen?

**Vasilika Hysi** – Pas nenit 32. Pra, para nenit 33 duhet të shtojmë diçka tjetër.

Ne kemi bërë një ndryshim te kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor. I kemi dhënë kompetencë Këshillit të Lartë Gjyqësor në nenin 147/a, germa “dh”, që propozon dhe

administron buxhetin e tij dhe të gjykatave, ndërkohë që në Kushtetutën aktuale, neni 144 parashikon që gjykatat kanë buxhet të veçantë, të cilin e administrojnë vetë. Ata e propozojnë buxhetin e tyre sipas ligjit. Të dyja këto rregullime bien ndesh, pra duhet shfuqizuar neni 144 i Kushtetutës. duhet të fusim një nen këtu, me argumentin që kjo tashmë i ka kaluar si kompetencë Këshillit të Lartë Gjyqësor nëpërmjet germës “dh”, pra duhet të shtojmë 32/1, ku të thuhet që neni 144 shfuqizohet.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord ekspertët me këtë propozim?

**Jon Smibert**– Po dakort. Kjo është reflektuar në versionin anglisht dhe shkon në mënyrë perfekte.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me propozimin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 32? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 33 do të ketë një lëvizje të numrave të neneve, por besoj se do të reflektohet kur të zbardhet projekti. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 34? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 35? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 36? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 37? Urdhëroni, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Në nenin 37 mendoj se është harruar të shtohet se qenia anëtar i gjykatës së Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk pajtohet me asnjë veprimtari politike ose shtetërore, si dhe veprimtari të tjera profesionale.

Pra, nuk është futur veprimtaria politike. Kjo është bërë për shkak, se ata janë gjyqtarë? Unë them që jo, sepse në Këshillin e Lartë Gjyqësor kemi edhe anëtarë jogjyqtarë. Pra, mund të jetë një lapsus, pra, mund të jetë harruar fjala “politike”.

**Fatmir Xhafaj** – Ka komente nga ekspertët?

Zoti Sadushi, urdhëroni!

**Sokol Sadushi** – Është e saktë. Është formulimi, që është ndjekur në të gjitha dispozitat, por ndoshta këtu është harruar. Ka të drejtë, zonja Hysi.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord me ndryshimin? Miratohet neni 37 me ndryshimin.

Faleminderit!

Neni 38? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 39? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40? Urdhëroni!

**Vasilika Hysi** – Unë kam një pyetje për nenin 40. Është një nga nenet që ne kemi diskutuar, në lidhje me kontrollin parlamentar. Në mbledhjen e kaluar ne diskutuam në lidhje me pretendimet për shkeljet disiplinore të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Mund t'i lihej ose një deputeti ose Komisionit të Ligjeve. Shikoj që varianti i sjellë nga ekspertët i është lënë një deputeti të Kuvendit, konkretisht të Komisionit të Ligjeve.

**Fatmir Xhafaj** – Je dakord me *foot note*-in?

**Vasilika Hysi** – Po.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord. Edhe unë bie dakord me zonjën Hysi, për të mbajtur atë që është thënë në *foot note* si version.

Biem dakord të gjithë? Jemi dakord me ndryshimin? Dakord. Të reflektohet ndryshimi.

Neni 40 miratohet me ndryshimin.

Faleminderit!

Faleminderit, zonja Hysi për kontributin!

Neni 41? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 42? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Smibert, urdhëroni!

**Jon Smibert** – Në nenin 42 është një ndryshim për të cilin kemi folur më parë dhe unë doja të isha i bindur që është reflektuar. Pika 4 e nenit 148 parashikon “ Prokuroria e posaçme dhe njësia e posaçme hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale kundër funksionarëve të lartë”, çka përputhet me atë çfarë ne kemi diskutuar më parë në lidhje me pikën 2 të nenit 135. Menduam se kjo është gjuha që duhej të përdorej.

**Fatmir Xhafaj** – Pra, shqetësimi që u ngrit nga zoti Vasili është i reflektuar në këtë nen dhe është i specifikuar qartë.



Zoti Smibert bëri sqarimin për të mbështetur shqetësimin që u ngrit nga zoti Vasili dhe neni 42 e pasqyron qartë.

Neni 43? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 44? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 45? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 46? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 47? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 48? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 49? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 50? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 51? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 52? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 53? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 54? Këtu ka një *footnote*, por që të jem i sinqertë, që mua më pëlqen fort, dua të them se edhe në tryezën ku kemi qenë me zotin Vasili dhe me zotin Basha, edhe ai ishte kundër shortit. Apo e kam gabim, zoti Vasili? Edhe ai ishte atëherë, por, meqenëse këtu kolegët...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Urdhëro!

Jo ju, zoti Basha, që trajtoi çështjen e shortit...

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Jo ju, jo, kur ishim bashkë...

**Petrit Vasili** – Po, e ngriti.

**Fatmir Xhafaj** - Zoti Basha e trajtoi dhe ishte kundër idesë së shortit në misionet, sepse nuk zgjedhim më të mirin. Me thënë të drejtën unë jam dakord me propozimin e zotit Basha, por do të sugjeroja...

Ah, ky konsensusi i shkretë! E kam të vështirë, a mund ta lëmë këtë dhe ta miratojmë kështu siç është dhe kur të bëjmë ndryshimin e formulës ta vendosim që sot, nëse edhe kolegët tanë të opozitës janë dakord për ta futur këtë gjë, mos ta bëjmë këtë hap se nesër se mund të keqkuptohemi për të mos lënë asgjë?

Po, zoti Deville.

**Rainer Deville** – Në pikën 5 ne kemi përfshirë mundësinë për të vendosur kritere të tjera të kualifikimit. Kemi parashikuar mundësinë për ta qartësuar dhe nuk është e domosdoshme të jetë një ndryshim kushtetues.

**Fatmir Xhafaj** – Gjithsesi, për mua një strukturë e tillë me kaq peshë në këtë proces do ta kishte të domosdoshme që së paku të kishte aty kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë, që zgjidhen nga vetë trupat gjyqësore, pra ata kanë marrë mbështetjen e tyre. Por, le ta lëmë këtë pikë kështu siç është me dëshirën për ta diskutuar dhe nëse gjejmë një zgjidhje të përbashkët mirë, në qoftë se nuk gjejmë atëherë le të mbetet kështu siç është.

Po, zoti Ibrahim!

**Gent Ibrahim** – Unë e mirëkuptoj hezitimin tuaj për ta kthyer atë zgjidhjen e vjetër, pavarësisht se me sa duket ka konsensusin nga të gjitha palët që të kthehemi te zgjidhja e vjetër për sa i takon përbërjes së këshillit të emërimeve, pra tek ajo zgjidhje që kërkon në përbërjen e këtij këshilli figurat më të larta të drejtësisë. Vetëm se duhet të keni parasysh se këto ndryshime duhet të reflektohen edhe në ligj, kështu që unë shpresoj që të mos jetë 2 orët e fundit ndryshimi.

**Fatmir Xhafaj** – Kërkoj mirëkuptimin tuaj. A mund të bëjmë vetëm një gjë? Këtu janë dy gjyqtarë kushtetues, dy gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, të paktën kryetarët, pra nga këta të lëmë një gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese dhe një gjyqtar të Gjykatës së Lartë dhe lëmë Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe kryetarin e Gjykatës së Lartë? A mund të jetë kjo një zgjidhje që nuk kontestohet me logjikën që kanë edhe kolegët tanë të opozitës.

Po.

**Gent Ibrahim** – Në rast se ju e keni atë merakun që artikuluar pak më parë, duhet të keni parasysh që do të jetë nevoja për një ndryshim në ligj dhe ky ndryshim të vijë në një kohë të arsyeshme. Po kjo që sapa unë thashë ishte politike në fakt, ju kërkoj ndjesë.

**Fatmir Xhafaj** – Unë kisha vetëm këtë, që të fusim kryetarin e Gjykatës së Lartë dhe kryetarin e Gjykatës Kushtetuese dhe ngelet një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe një gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Po kemi dy autoritete të rëndësishme që i kemi pjesë dhe është i vetmi përjashtim që mund të bëjmë. Ndajeni ju tani.

**Rainer Deville** – Ky ishte një nga diskutimet që patëm me opozitën. Në draftin origjinal ne i kishim këto personalitete dhe shqetësimi që është ngritur në atë kohë nga Partia Demokratike ka qënë se ne nuk duam të kemi një person specifik për këtë punë dhe opozita propozoi këtë. Ne në nivel eksperti e kemi pasur këtë ide dhe nëse i rikthehemi versionit të vjetër mund të krijojë konflikt përsëri. Teknikisht, nuk është keq. Mbetet vetëm pyetja për zhvillimin politik.

**Fatmir Xhafaj** - Në rregull. Sepse e kisha një ide se do të më mbështesnit, megjithatë, dakord. Të ngelet siç është, me rezervën që thamë.

A jeni dakord?

*(Diskutime pa mikrofon.)*

**Vasilika Hysi** – Kam një merak. Unë jam dakord me shtesën që është bërë në paragrafin 5, që duhet të ketë kritere për personat që do të marrin pjesë, por këto kritere duhet të jenë shumë të forta.

**Fatmir Xhafaj** – I kemi në ligj.

**Vasilika Hysi** – Duhet të jenë shumë të forta, sepse rrezikon që...

**Fatmir Xhafaj** – Zonja Hysi...

**Vasilika Hysi** – Njerëz të rinj fare, të cilët presin që të bëjnë karrierë në të ardhmen t'i vësh në këshillin e emërimeve...

**Fatmir Xhafaj** – Ligji këtë do kalojë. Do të kalojë ligji këtu dhe do ta shohim.

Dakord, 54-a votohet me rezervën që thamë.

55-a? Dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

56-a. Dakord. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

57-a.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Te 57-a?

**Petrit Vasili** – Kam një koment te pika 4, ku trajtohet problemi i rivlerësimit me këshilltarët ligjorë e të tjerë. Korrekte.

Në frazën e dytë kemi sanksionuar procesin e rivlerësimit edhe për ish-gjyqtarë, ish-prokurorë, ish-këshilltarë ligjorë e të tjerë. Pyetja ime logjike, meqenëse ka elemente parimore, është: ne kemi një sistem, të cilin po synojmë ta shëndoshim, po synojmë të bëjmë transfuzion të ri në të, ku të kemi edhe njerëz që studiojnë më së miri, studiojnë edhe jashtë Shqipërisë, pra hapin portat e sistemit. Ndërkohë, këtu mundësojmë dukshëm riciklimin e personave që kanë qenë në sistem dhe kanë dalë. Na hyn në punë për këtë proces kaq të shëndetshëm që ne po ndërtojmë në drejtësi, të përfshijmë apo të mundësojmë një mekanizëm të tillë? Personalisht, do të thosha se nuk më duket gjetje pozitive, por, në rast se do të kishim mundësi të refleктоhej, sigurisht do të isha i kënaqur; në rast se nuk do të kishim mundësi, përsëri unë do ta votoja nenin, por me këtë rezervë, pasi nuk mendoj se japim ndonjë mesazh pozitiv apo shpresëdhënës për shumë njerëz që presin të hyjnë në drejtësi. Besoj se drejtësia shëndoshet kur gjithmonë e më shumë të rinj hyjnë në sistem dhe aq më tepër që sot kemi shumë e më shumë, për shkak të sakrificave që bëjnë shumë familje shqiptare, që diplomojnë fëmijët e tyre edhe në shkolla shumë të mira jashtë Shqipërisë, të cilët normalisht ne duhet të kishim mundësi që me padurim pjesën më të mirë të tyre ta bënim pjesë të sistemit tonë. Ky risistem, kjo mënyrë dhe kjo dritare për këtë kategori besoj se do të krijonte një pengesë artificiale dhe nuk besoj se ne do të jepnim mesazhin që jep drafti i reformës në tërësinë e tij. Në qoftë se do të kishte mundësi rishikimi kjo pjesë, do të isha i kënaqur; në qoftë se jo, nuk ka problem.

**Fatmir Xhafaj** – Unë kam vetëm një merak, po e them edhe për ekspertët, zoti Vasili. Ka raste, dhe po marr një rast konkret: kam parë se X gjyqtar shkruan në gazetë dhe kam pyetur për të, sepse është gjë e rrallë që gjyqtarët të shkruajnë. Thonë se ai ka të paktën 2-3 vjet që ndodhet në Kanada, është shkëputur nga gjyqësori, nuk ia mbaj mend emrin, të jem i sinqertë, por ka qenë gjyqtar i Shkallës së Parë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon).*

Ai është shkëputur nga sistemi dhe, nëse ne nuk i japim këtë mundësi, nuk hyn më në sistem, por nuk mund të hyjë automatikisht pa bërë rivlerësimin, por, ndërkohë, ai po bëhet doktor shkencash në Kanada dhe unë këtë merak kam.

Por, nga ana tjetër, jam absolutisht dakord me zgjerimin që do t'i bëhet dhe nevojës që ne kemi për të futur vajza dhe djem që janë shkolluar dhe trajnuar jashtë shtetit. Kjo do të na duhet, që kur të shikojmë ligjin përkatës, që do të vijë te ligji kuadër, ta fusim këtë element, të jetë një ndër elementet e prioritetëve që do të kemi. Në qoftë se biem dakord kështu, edhe unë do ta vlerësoja mirëkuptimin me ju.

Biem dakord, zoti Vasili?

**Petrit Vasili** – Singerisht, ne jemi në një moment parimor të reformës dhe besoj se principaleti na shtyn të japim mesazhe shumë të qarta dhe një qasje krejt të re për reformën. Unë jam shumë dakord me ju, që ka shembuj të shkëputur, të cilët mund të justifikojnë, por nuk mund të justifikojnë shembujt e shkëputur një dispozitë kushtetuese, pasi qëllimi i kësaj është shumë më i gjerë sesa individët. Reforma ka një dimension dhe një thellësi të tillë, që edhe njerëz, të cilët janë dhe kanë shërbyer gjatë, për hir të mekanizmit shumë korrekt të reformës, do të detyrohen të dalin nga sistemi.

Pra, ne sot shëndoshim sistemin dhe shembujt e shkëputur apo zgjedhjet individuale që bën dikush në jetë, nuk mund të na afektojnë në marrjen e pozicionit. Për mua, ne duhet të japim një qasje të qartë. Dyert e sistemit tashmë u hapën për vlerat, ne presim që sistemi të freskohet gjithmonë e më shumë, kemi besim, në mënyrë të veçantë, te forcat e reja që hyjnë në sistem me një mentalitet të ri dhe, edhe sikur, dikush, tek-tuk të sakrifikohej për shkak të kësaj, do të ishte një sakrificë plotësisht e mirëpritur, pasi ne të gjithë e mirëpresim që në trupat gjykues dhe të prokurorisë të shikojmë kualitete të reja dhe njerëz me mendje të re. Besoj se, të nisur nga shembulli, nuk jemi shumë solidë në dispozitë, sigurisht, nuk e kam këtë objekt të një kokëfortësie vanitoze, por si një qasje, meqenëse jemi përpjekur në të gjitha rastet të jemi gjerësisht parimor dhe të japim mesazh pozitiv.

**Fatmir Xhafaj** – E lëmë që të shikojmë edhe ligjin kuadër që do të trajtojmë këtu dhe nëse nuk i plotëson pritshmëritë tuaja ne i rikthehemi para se ta votojmë në parlament? Dakord? Në rregull!

Atëherë neni 57. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Dakord me nenin 58 “Hyrja në fuqi”? Dakord!

Miratohet.

Vazhdojmë me aneksin “Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe i prokurorëve”.

Kam një pyetje për zotin Sadushi: ne do t’i numërtojmë si neni A, neni B, neni C, apo do t’u vendosim numra sipas logjikës që përdor Kushtetuta? A do të bëjmë përjashtim në këtë rast për shkak edhe të referencës që do të bëjmë më vonë? A ju shkon kështu me germa, se ju jeni ekspert dhe ju e keni zgjidhur?

**Sokol Sadushi** - Është e pranueshme edhe në këtë variant, ashtu siç mund të jetë i pranueshëm edhe varianti që sapo thatë. Ky është një aneks dhe, në fakt, nuk do të ketë një jetëgjatësi të madhe. Sidoqoftë, nga pikëpamja e teknikës nuk është e gabuar që t’i emërtojmë nenet me germa, për të bërë edhe një lloj difference me trungun kushtetues. Kështu që ne kemi gjetur këtë model, që na duket i arsyeshëm, por, sidoqoftë, edhe emërtimi me numra është

një zgjidhje e arsyeshme. Pra, është çështje përshtatjeje, por ne i identifikojmë më qartë me germa.

**Fatmir Xhafaj** - Në rregull!

Atëherë, do t'i emërtojmë nenet me germa, si neni A, neni Be e të tjerë.

Atëherë, neni A. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni B. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni C “Dispozitat e përgjithshme për Komisionin dhe Kolegjin e Apelimit”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni Ç “Rivlerësimi”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni D “Vlerësimi i pasurive”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni DH “Kontrolli i figurës”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni E “Vlerësimi i aftësive profesionale”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni Eë “Masat disiplinore”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni F “Kolegji i Apelimit”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni G “Dorëheqja”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ky ishte neni i fundit i projektit.

Kush është dakord me votimin në tërësi të projektligjit? Pro? Kundër? Abstenim ?  
Nuk ka.

Miratohet projektligji në tërësi, me rezervën që lamë.

Faleminderit të gjithëve për bashkëpunimin!

Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj ekspertët, të cilët kanë bërë një punë të palodhur, dy ekspertët ndërkombëtarë, zotin Deville dhe zotin Smibert! Gjithashtu, falënderoj ekspertët shqiptarë: zotin Sadushi, zonjën Anastasi, zonjën Ibrahimimi dhe zonjën Vorpsi!

Falënderoj ekipet e mrekullueshme të EURALIUS-it dhe të OPDAT-it, si dhe zonjat e sekretariatit teknik dhe të gjithë atyre që kanë punuar me muaj, orë e pa orë, të shtunave dhe të dielave, që kanë qenë të detyruar t'u mungojnë gjatë gjithë kësaj periudhe familjeve të tyre në funksion të këtij projekti, duke bërë një punë të jashtëzakonshme, që besoj se për vite të tëra do të vlerësohen për këtë projekt, për këtë eksperiencë dhe për këtë kontribut të jashtëzakonshëm.

Edhe një herë faleminderit të gjithëve, ambasadores Vlahutin, ambasadorit Lu, faleminderit edhe ekipit teknik që mundësoi seancën e sotme, pa dyshim edhe përkthyesve!

Besoj se për 2 ose 3 ditë do të kemi mbledhjen e komisioni për vazhdimin e projektligjeve. Faleminderit!

### **MBLEDHJA MBYLLET**

*Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga staf i teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*